

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E SHTERPÇËS
OPŠTINA STRPCE
MUNICIPALITY OF SHTERPCE

Duke u bazuar në nenin 12 dhe 17 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr-03/L-040 dhe Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr-03/L-049, Kuvendi i Komunës së Shtërpcës në mbledhjen e mbajtur më datë: 31/05/2010 aprovoi këtë:

RREGULLORE
PËR TAKSAT, TARIFAT DHE GJOBAT KOMUNALE

I. DISPOZITAT E PËRGJITHËSHME

Neni 1
Objekti i rregullimit

1.1 Me Rregulloren për taksat, tarifat dhe gjobat komunale (në vazhdim të tekstit Rregullore), me qëllim të krijimit të burimeve të të hyrave vetanake të Komunës , përcaktohet :

- Lloji i taksave, i tarifave dhe gjobave komunale, fushat e aplikimit , obliguesit, lartësia dhe mënyra e pagesës,
- Detyrat dhe përgjegjësitë për zbatimin e Rregullores dhe
- Procedura e Ankesës në aktet mbi përcaktimin e obligimeve të pagesave.

1.2 Taksat, tarifat dhe gjobat komunale janë të hyra buxhetore të Komunës, të arkëtuara nga obliguesit e caktuar me këtë Rregullore.

Neni 2
Aplikimi

Komuna në pajtim me dispozitat ligjore dhe me këtë Rregullore, aplikon taksat, tarifat dhe gjobat për punët dhe shërbimet, të cilat sipas kërkesës së qytetarëve - personave fizik dhe juridik i kryejnë Organet Komunale nga fushëveprimi i tyre, për lejet për ushtrimin e veprimtarive afariste në territorin e Komunës, për rastet e shkeljeve të dispozitave të rregulloreve komunale si dhe për kompensimet dhe aktivitetet tjera të Komunës të përcaktuara me këtë Rregullore.

II. TAKSAT

Neni 3
Taksat për marrjen dhe mbajtjen e Lejes për ushtrimin e veprimtarive afariste

3.1 Këtë taksë janë të obliguar ta paguajnë subjektet e biznesit të cilat në territorin e Komunës ushtrojnë veprimtarin e regjistruar afariste.

3.2 Taksat përcaktohet në shumë vjetore dhe paguhet për marrjen dhe për mbajtjen e Lejes për ushtrimin e veprimtarisë afariste, për secilin objekt në të cilin ushtrohet veprimtaria e regjistruar afariste.

3.3 Taksa për marrjen e Lejes , paguhet me rastin e marrjes së Lejes, në shumën e përcaktuar të bazës vjetore për vitin kalendarik në të cilin lëshohet Leja për ushtrimin e veprimtarisë afariste.

Propozim alternativ i paragrafit 3.3 (par. 3.3 dhe 3.4)

3.3 Taksa për marrjen e Lejes, paguhet me rastin e marrjes së Lejes, në shumën e përcaktuar të bazës vjetore për vitin kalendarik, prej datës të regjistrimit të veprimtarisë afariste për lokalin përkatës afarist.

3.4 Për lokalet, për të cilat subjektet afariste nuk kanë aplikue për leje pune sipas rregulloreve paraprake, shumës së taksës për marrjen e lejes për ushtrimin e veprimtarisë afariste nga paragrafi paraparak, do ti shtohet edhe shuma e llogaritur prej datës të regjistrimit të veprimtarisë afariste, sipas lartësisë së taksës të përcaktuar sipas rregulloreve paraprake.

3.5 Me rastin e marrjes së lejes nga paragrafi paraparak subjektet afariste duhet të paguajnë edhe obligimet e mbetura nga posedimi i lejeve të mëparshme të punës.

3.6 Pas marrjes së lejes, taksa për mbajtjen e Lejes përcaktohet në shumë vjetore me aktvendim të Drejtorisë për Buxhet dhe, Financa dhe paguhet për çdo vit, në dy kiste të barabarta, për secilin objekt për të cilin ipet leja për ushtrimin e veprimtarisë afariste. Kisti për gjashtëmujorin e parë do të paguhet më së largu deri më 30 qershor, ndërsa kisti i dytë deri më 31 dhjetor të vitit kalendarik.

3.7 Aktvendimet për pagesë të taksës për mbajtjen e lejes për ushtrimin e veprimtarisë afariste, iu dërgohen subjekteve afariste, më së voni, një muaj para fillimit të vitit kalendarik.

3.8 Në rastet kur skadon afati i Lejes, me rastin e parashtimit të kërkesës për marrjen e Lejes së re, obliguesi duhet të paguaj në tërësi shumën vjetore të taksës si dhe shumën e obligimeve të mbetura të taksës nga perioda paraprake për objektin për të cilin kërkon Lejen.

3.9 Obliguesit, taksën për marrjen dhe mbajtjen e Lejes për ushtrimin e veprimtarisë afariste do ta paguajnë për secilin objekt sipas veprimtarisë afariste, në shumën e përcaktuar sipas numrit rendor të taksave, si vijon:

Nr.1 Ndërmarrja prodhuese (industriale), ndërmarrjet prodhuese komerciale dhe shërbimet:	
- Kategoria e parë – ndërmarrjet shoqërore industriale (metalike, e drurit, ushqimore dhe prodhimet tjera).....	400 €
- Kategoria e dytë – ndërmarrjet e shitjes me shumicë.....	200€
- Kategoria e tretë – ndërmarrjet tjera prodhuese.....	150€
- Kategoria e katërt – ndërmarrjet tjera të pacekura.....	100€
- Secila ndërmarrje e cila shfrytëzon më shumë se një object afarist për ushtrimin e veprimtarisë ekonomike, paguan taksën për qdo object shtesë nga.....	50€
Nr.2 Pompat e bënzinës (derivative të naftës).....	400€
Nr.3 Bankat, filialet e tyre dhe agjensitë tjera që merren me kreditë.....	600€
Nr.4 Këmbimoret.....	100€
Nr.5 Kompanitë e sigurimeve.....	250€
Nr.6 PTT trafiku dhe distribucioni.....	500€
Nr.7 Prodhimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike.....	500€
Nr.8 Tregtia private:	
• Shitoret e pavarura.....	50€

- Shitoret me pakicë.....100€
- Shitoret me shumicë.....200€
- Butiqet.....50€
- Tregtia me mobile dhe aparate elektrike.....100€
- Tregtia me pakicë e produkteve tjera në shitoret e specializuara.....100€
- Tregtia me automjete të havarisura.....100€
- Tregtia me pjesë të automjeteve motorike.....50€
- Tregtia me shumicë e artikujve ushqimore, pijeve dhe duhanit.....200€
- Tregtia me pakicë me kompjuterë dhe paisjeve të tyre.....150€
- Tregtia me pakicë e prodhimeve farmaceutike.....150€
- Tregtia me pakicë e paisjeve sanitare.....150€
- Tregtia me pakicë e aparateve elektrike, radiove TV aparateve etj.....100€
- Tregtia e ndërmarrjeve me shumicë dhe pakicë (depot ushqimore).....200€
- Tregtia me pakicë e prodhimeve optike.....50€
- Tregtia e ndërmarrjeve me pakicë e shumicë e materialit ndërtimorë.....200€
- Tregtia me pakicë e tekstilit, mobilieve, veshmbathjes, artikujve sportive, kozmetikës, librave, fletoreve, ngjyrave, laqeve, artikujve të vogla të metalit, lodrave për fëmijë, aparateve për ndriqim, perdeve, prodhimeve të lëkurës.....50€
- Tregtia me artikuj të përdorur.....50€
- Ndërmarrjet ndërtimore me deri 5 punëtorë.....100€
- Ndërmarrjet ndërtimore me mbi 5 punëtorë.....150€
- Ndërtimet e larta.....250€
- Mekanizmi i rëndë.....100€
- Nd. tregtare prodh. (përpunimi, shitja, prodh. Personale).....150€
- Nd. tregtare prodh. (përpunimi, shitja e prodh. Të mishit).....150€
- Nd. tregtare prodh. (produkteve të drurit, dyerve, dritareve).....200€
- Nd. tregtare prodh. (produkteve nga plastika, dyerve, dritareve).....200€

Nr.9 Kooperativat bujqësore:

- Tregtia me pakicë – shitja e farës dhe e plehrave.....100€
- Tregtia me shumicë – shitja e farës dhe e plehrave.....150€
- Tregtia e paisjeve bujqësore.....150€

Nr.10 Lojërat e fatit:

- **Veprimtaria me lojëra të fatit, bastoret.....400€**
- Lojaërat e fatit – kazinot.....500€

Secili subjekt afarist I lartecur, për qdo objekt shtesë paguan shumën e njëjtë të taksës së përcaktuar të veprimtarisë përkatëse.

Nr.11 Objektet shërbyese, hoteliere:

- **Hotelet.....500€**
- **Motelet.....300€**
- Restorantet.....150€
- Kafiteritë.....150€
- Ëmbëltoret, hamburgerët, shitoret e ushqimit të shpejtë, qajtoret.....50€
- Agjensionet turistike.....50€

Vërejtje: - Objektet hoteliere, puna e të cilave është e lidhur vetëm për një sezonë, ato do të paguajnë taksën për atë kvartal në të cilin ushtrohet veprimtaria.

Nr.12 Punëtoritë e pavarura:

- Argjentaritë.....100€

- Zdrukthtaria.....50€
- Bukëpjekësit.....100€
- Mishtoret.....75€
- Gomisteritë.....30€
- Autoserviset.....50€
- Autoelektricitët, agjustatorët, ortarët, fotografët, fotokopjuesit, rrobaqepësit, instaluesit e ujit, sallonet e ondulimit, autolarjet30€
- Xhamprerësit.....50€
- Shitoret e tjera zejtare.....50€

Nr.13 Autotransportuesit:

- Ndërm. Transportuese e udhëtarëve prej 01-03.....150€
- Ndërm. Transportuese e udhëtarëve mbi 03.....250€
- Ndërm. Transportuese e mallrave.....100€
- Autobusët.....100€
- Autotaksistët.....30€
- Kombitaksistët.....50€
- Veprimtaritë e agjensioneve të udhëtimit.....50€

Nr.14 Telekomunikimet:

- Video klubet, incizuesit, shumëzuesit.....50€
- **Internet&telefon.....200€**
- **Radio stacionet.....100€**
- **TV stacionet.....200€**
- Produksioni muzikor.....100€
- Shtypshkronjat.....100€
- **Repetitorët.....500€**

Nr.15 Për hyrje dhe shfrytëzimin e parkingut në parkun nacional dhe qendrën e skijimit:

- Për person.....1€
- Automjetet e lehta të udhëtarëve.....3€
- Për kombi, kamprimorkio, xhip.....5€
- Autobusë.....20€
- **Taksat e cituara nen Nr. 15 aplikohen per periudhen kohore nga data 15 e muajit 12 deri me daten 15 te muajit te 04 te qdo viti kalendarik**

Vërejtje: Nga taksat komunale lirohen farkëtarët, qerrepunuesit, mbathtarët, samarpunuesit, leshpunuesit, përpunuesit e kapelave, dhe zejtarë tjerë me qëllim të ruajtjes së traditës së tyre. **Taksa me nr. Rendor 15 për person nuk aplikohet për fëmijët deri 7 vjet dhe për banorët e komunës së Shtërpcës.**

Neni 4

Taksa për marrjen dhe mbajtjen e Lejes për ushtrimin e veprimtarive profesionale

4.1 Këto taksa përcaktohen për secilin objekt afarist për të cilin ipet leja për ushtrimin e veprimtarive profesionale.

4.2 Për përcaktimin e obligimit dhe mënyrës së pagesës të këtyre taksave do të vlejnjë procedurat sikur për taksat për Leje për ushtrimin e veprimtarisë afariste.

4.3 Obliguesit, taksën për Leje për ushtrimin e shërbimeve profesionale do ta paguajnë në shumën e përcaktuar sipas kësaj skeme tarifore:

Nr.	Shuma e taksës	Shifra dhe veprimtaria afariste e obliguesit	
1	150 €	74.11	Avokatët
2	100 €	80.41	Veprimtaritë shkollore për shofer – Autoskollat
3	100 €	74.11	Punët tjera juridike, llogaritare, të kontabilitetit , të revizionit dhe këshilla për tatime
4	200 €	74.20	Veprimtaritë e arkitekturës dhe inzhinierisë dhe këshillimet lidhur me to (Byrot projektuese)
5	150 €	85	Mbrojtja shëndetësore dhe sociale (Ordinancat mjeksore, stomatologjike, gjinek. dhe të veterinarisë).
6	200 €	74.30	Kontrollime teknike dhe analiza (Kontrolli teknik i automjeteve)

Neni 5

Taksat për lëshimin e certifikatave dhe dokumenteve zyrtare

5.1 Këto taksa i implementojnë Organet Komunale të cilat nga fushëveprimi i vet lëshojnë vërtetime dhe dokumente zyrtare .

5.2 Obligues të pagesës janë qytetarët - personat fizik dhe juridik të cilët me kërkesë iu drejtohen Organeve Komunale për lëshimin e dokumenteve zyrtare .

5.3 Paguesa e këtyre tarifave bëhet me rastin e parashtrimit të kërkesës.

5.4 Këto tarifa caktohen për lëshimin e këtyre dokumenteve:

Nr.	EMERTIMI(I ngarkesave, kompensimeve dhe taksave ne shërbime	
1	Për pranimin e kërkesës	0.5 €
2	Vërtetimi i fotokopjes-formati A4x1	0.5€
3	Vërtetimi i fotokopjes-formati A3x1	1€
4	Vërtetimi i deklaratës mbi raportin e lidhjes familjare	1€
5	Vërtetimi i deklaratës qe personi është i vetëm	1€
6	Vërtetimi i deklaratës mbi vendqëndrimin e përkohshëm	1€
7	Vërtetimi i deklaratës mbi varshmërin materiale	1€
8	Për huazimin e dokumenteve te lejueshme nga arkivi	5€
9	Vërtetimi i deklaratës mbi mbikëqyrjen e anëtarit te familjes	1€
10	Vërtetimi i deklaratës mbi jetën e përbashkët deri ne vdekjen e bashkëshortit	1€
11	Për përkthimin e dokumenteve - (për faqe)	3€
12	Për përpilimin e autorizimit - pëlqimit	4€
13	Për përpilimin e kërkesave, deklaratave etj	2€
14	Për vërtetim të autorizimit – pëlqimit	2€
15	Për ankesë kundër vendimit të cilin e bie organi i shkallës së parë, paguhet tarifa në shumën prej:	1€
16	Kërkesa për certifikatë të lindjes	1€
17	Kërkesa për certifikatë të martesës	1€

		Pa pagese
18	Kërkesa për certifikatë të vdekjes	
19	Për akt vdekje (trashëgimia)	3€
20	Për ceremonialin e lidhjes së martesës	5
21	Për regjistrimin e mëvonshëm të faktit të lindjes	5€
22	Regjistrimi i mëvonshëm i vdekjes	1€
23	Për ndërrimin e emrit personal (deri në moshën 18 vjeçare)	10€
24	(mbi moshën 18 vjeçare)	20€
25	Për korrigjimin e shënimeve në librat amëz	5€
26	Për lidhje të martesës jashtë orarit të punës	20€
27	Për lidhje të martesës jashtë selis së Komunës	30€
28	Për lidhje të martesës, kur njëri bashkëshort është shtetas i huaj	30€
29	Për deklaratë të bashkësisë familjare-për përdorim në Kosovë	1€
30	Për deklaratë të bashkësisë familjare jashtë Kosovës	5€
31	Për regjistrimin në librat special të lindjeve, martesave-jashtë Kosovës	2€
32	Për vërtetimin e shtetësisë	2€
33	Për vërtetimin që personi është në jetë	2€
34	Për certifikatë të statusit të lire martesor	1€
35	Për vërtetim të vendbanimit ose vërtetime tjera	1€
36	Për konfirmim lënda e martesës, me kërkesë të DRGJC	3€
37	Për konfirmim të certifikatave, LAI, I.AM e tjera	1€
38	Për lidhje të martesës me shtetas të huaj-jashtë orarit të punës	30€
39	Për lidhje të martesës me shtetas të huaj jashtë orarit dhe jashtë selis së komunes	50€
40	Për personin zyrtar në lidhje të martesës (jashtë orarit dhe jashtë selis)nga pala duhet të bëhet kompensimi për mëditje në shumë prej:	20€
	Personat e liruar nga participimi në shërbimet e Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme	
	Rastet sociale (Dëshmia nga Qendra për punë sociale – vlefshmëria e kartelës) në përjashtim të pikave 26,27,28,38 dhe 39	

Sektori i Ofiqarise- Certifikatat

Neni 6 Taksa administrative komunale

6.1 Obligues për pagesë të taksës administrative komunale janë personat fizik dhe juridik të cilët sipas procedurës së përcaktuar kërkojnë ofrimin e shërbimeve të caktuara nga Komuna.

6.2 Kjo taksë paguhet me rastin e parashtrimit të kërkesës, për veprimet administrative, si vijon :

1. Kërkesa për shiqimin e objektit mbi plotësimin e kushteve minimale teknike për ushtrimin e veprimtarisë afariste : për koston e punës 25 Euro dhe për shpenzime të transportit me automjet zyrtar nga 0.50 Euro për çdo kilometer të kaluar.

Neni 7
Taksa për lejet urbanistike dhe strukturave të tjera

- a) Obligues të këtyre taksave janë personat fizik dhe juridik të cilët kërkojnë leje për ndërtimin dhe rrënimin e ndërtesave dhe të strukturave të tjera.

LEJA URBANISTIKE

<i>Nr. R.</i>	<i>Titulli i dokumentit</i>	<i>Shuma €</i>
1.	Objektet banesore	25,00
2.	Objektet afariste	40,00
3.	Objektet kolektive banesore	70,00
4.	Objektet kolektive afariste	100,00
5.	Objektet industriale (tregtare, hotelet)	80,00
6.	Objektet prodhuese (fabrikat, pompat e benzinës)	100,00
7.	Objektet e përkohshëm	15,00
8.	Objektet ndihmëse (garazhet, tendat...)	15,00
9.	Antenat për TV stacione	150,00
10.	Antenat për Radio stacione	100,00
11.	Antenat për telefoni mobile	200,00
12.	Antenat për internet	100,00
13.	Parking hapësira	50,00
14.	Transformatorët	100,00
15.	Pishinat	50,00
16.	Terrenet sportive	50,00
17.	Objektet tjera	15,00-40,00

Taksa për lejet për ndërtimin dhe rrënimin e ndërtesave dhe të strukturave të tjera

LEJA NDËRTIMORE

Ky kompensim përcaktohet sipas Zonave të caktuara në Rregulloren komunale mbi tatimin në pronë dhe destinimit të objektit, për sipërfaqen e lejuar për ndërtim sipas Lejes ndërtimore, si vijon :

18.	zona I	Objektet kolektive – zona banuese	m ³	1,20
19.		Objektet kolektive – zona afariste	m ³	1,40
20.		Ndërtesa private – hapësira banuese	m ³	0,70
21.		Ndërtesa private – hapësira afariste	m ³	1,00
22.	zona II	Objektet kolektive – zona banuese	m ³	0,90
23.		Objektet kolektive – zona afariste	m ³	1,10
24.		Ndërtesa private – hapësira banuese	m ³	0,40
25.		Ndërtesa private – hapësira afariste	m ³	0,70
26.	zona III	Objektet kolektive – zona banuese	m ³	0,50
27.		Objektet kolektive – zona afariste	m ³	0,80
28.		Objektet kolektive – zona banuese	m ³	0,20
29.		Objektet kolektive – zona afariste	m ³	0,40

NDËRTIMI I OBJEKTEVE EKONOMIKE INDUSTRIALE

30.	Zona prodhuese	m ³	1,00
31.	Pjesa administrative (zyrat)	m ³	2,00
32.	Parking hapësira	m ²	1,00
33.	Terrenet sportive	m ²	1,00
34.	Pishinat	m ³	1,00

OBJEKTET E PËRKOHSHËM

35.	Kamp shtëpizat	m ³	2,00-5,00
36.	Objektet nga druri	m ³	2,00-10,00
37.	Objektet nga metali	m ³	2,00-10,00
38.	Kontejnerët	m ³	2,00-5,00

ZONA TURISTIKE

39.	Objektet nga druri - kati	m ³	2,50
40.	Objektet nga druri – nën kulmi	m ³	1,00
41.	Material i fort - bodrumi	m ³	1,50
42.	Material i fort - kati	m ³	3,00
43.	Objekte nga materiali i fort – nën kulmi	m ³	1,50
44.	Objektet ndihmëse (furrat, garazhet, pishinat, vilat, muret mbrojtëse dhe rrethojat...)	m ³ / m ²	1,00
45.	Objektet afariste	m ³	5,00

TAKSAT PËR DALJE NË TERREN

46.	Zona e vikendit		35,00
47.	Sharri		50,00
48.	Zonat tjera komunale		10,00-30,00
49.	Rastet sociale – libreza valide e socialit		0,00

LEJET PËR RRËNIM

50.	Zona turistike	m ³	0,60
51.	Zonat tjera	m ³	0,15

OBJEKTET TJERA

52.	Reklamat	m ²	30,00
53.	Ndërtimi i urave		2% nga investimet

Vërejtje: Taksat për leje për shfrytëzimin e objekteve do të paguhen me 50% nga taksa e paguar për leje ndërtimi.

b) Tarifa për shëndërrimin e hapësirës banesore në hapsirë afariste

Kjo tarifë përcaktohet për sipërfaqen e lejuar në bazë të Vendimit për ndërrim të destinimit të hapësirës banesore në hapsirë afariste, në lartësi prej nga **10 €/m²**.

Neni 8

Taksa për rexhistrimin e automjeteve motorike

8.1 Obligues të taksës për automjete motorike janë banorët e komunës dhe shoqëritë e regjistruara tregtare që kanë selinë në Komunë, që kanë në pronësi automjete motorike.

8.2 Kjo taksë përcaktohet dhe paguhet në shumë vjetore me rastin e regjistrimit të automjeteve, si vijon: :

Nr.	Lloji i automjetit	Ngarkesa
1	Automjetet që peshojnë deri në 3.5 tonë	10€
2	Automjetet që peshojnë mbi 3.5 tonë	20 €

Shënim: Këto ngarkesa nuk do të paguhet për automjetet e ndihmës së shpejtë dhe të zjarrfikësve.

Neni 9

Taksa për parkimin e automjeteve në pronën komunale

Në zonat e pronës komunale të përcaktuara për parkim ditor të automjeteve , poseduesit e automjeteve duhet të ua paguajnë operatorëve ekonomik të caktuar nga Komuna, parkingun për një shfrytëzim në lartësi prej 0.30 € .

III. TARIFAT

Neni 10

Tarifat për regjistrimin e të drejtave pronësore, hipotekave dhe qirasë

Këto tarifa inkasohen në bazë të Udhëzimit Administrativ të Ministrisë të Shërbimeve Publike, nr.2006/1.

Neni 11

Tarifat dhe ngarkesat për shërbimet kadastrale

Tarifat për shërbimet kadastrale do të aplikohen në bazë të Udhëzimeve Administrative të miratuara nga Ministria e Shërbimeve Publike për tarifat e shërbimeve dhe të produkteve kadastrale të ofruara nga zyrat kadastrale komunale dhe kompanitë gjeodete të licencuara.

IV. TË HYRAT NGA QIRADHËNIA, SHFRYTËZIMI I PRONËS KOMUNALE DHE I SIPËRFAQEVE PUBLIKE

Neni 12
Të hyrat nga qiradhënia

12.1 Të hyrat nga qiradhënia përcaktohen në bazë të kontratave të lidhura në pajtim me dispozitat materiale dhe procedurale për dhënien me qira të pasurisë së Komunës, si vijon:

a) Dhënia me qira e objekteve – në bazë mujore

Destinimi	Zona – Vendndodhja e objekteve		
	I-rë - Çmimi/m ²	II-të - Çmimi/m ²	III-të - Çmimi/m ²
Për banim	1.5 €	1 €	0.70 €
Për afarizëm	4 €	3 €	2 €

b) Dhënia me qira e tokës bujqësore – në bazë vjetore

Boniteti	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII
Çmimi/1 ha	60 €	50 €	45 €	40 €	35 €	30 €	25 €	20 €

c) Dhënia me qira e kullosave – në bazë vjetore

Boniteti	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII
Çmimi/1 ha	50 €	45 €	40 €	35 €	30 €	25 €	20 €	10 €

12.2 Për inkasimin e të hyrave sipas kontratave nga pika a) , b) dhe c) të këtij neni do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Neni 13

Të hyrat nga shfrytëzimi i pronës komunale nga poseduesit e objekteve, lokaleve të përkohëshme dhe qoshqeve të vendosura me lejet përkatëse të Komunës

13.1 Obligues të pagesës të këtyre të hyrave janë poseduesit e objekteve, lokaleve të përkohëshme dhe qoshqeve të vendosura me lejet përkatëse të Komunës

13.2 Shuma e ngarkesës llogaritet në bazë vjetore, për çdo vit kalenderik, për çmimin vjetor të çdo m² të sipërfaqes së objektit .

13.3 Vendimet mbi obligimin e pagesës i nxjerr Drejtoria për Buxhet dhe Financa. dhe ua dërgon obliguesve para fillimit të çdo viti kalenderik për obligimin e pagesës, sipas shumave të përcaktuara në vijim:

Nr	OBJEKTI DHE VEPRIMTARIA	VENDI	BAZA	SHUMA
1	Lokalet – objektet e përkohëshme për kryerjen e veprimtarive zejtare, shërbyese dhe hoteliere, ekonomike, për shitjen e prodhimeve industriale, bujqësore dhe gjërave tjera ushqimore, si dhe objekte tjera të ngjajshme	Zona e I-rë	M ²	10 €
		Zona e II-të	M ²	7 €
		Zona e III-të	M ²	3 €

2	Qoshqet për shitjen e gazetave, revistave, duhanit, librave, lotarive, bizhuterive, suvenireve, bukës dhe brumërave.	Zona e I-rë	M ²	8 €
		Zona e II-të	M ²	5 €
		Zona e III-të	M ²	2 €
3	Garazhat për automjete personale		M ²	2 €

Neni 14

Të hyrat nga shfrytëzimi me afat të caktuar i hapësirave publike në pronësi të Komunës për vendosjen e objekteve lëvizëse dhe sezonale

14.1 Këto të hyra i përcakton Drejtoria për Buxhet dhe Financa , në bazë të kërkesës të subjekteve afariste për dhënien e Lejes për shfrytëzim me afat të caktuar të hapësirave komunale për vendosjen e objekteve lëvizëse dhe sezonale , duke vendosur në procedurë me konkluzion mbi obligimin e pagesës, para nxjerrjes së Vendimit për dhënien e Lejes për shfrytëzim .

14.2 Lartësia e obligimit përcaktohet për kohëzgjatje të përcaktuar në Lejen për shfrytëzim, si vijon :

Nr.	EMËRTIMI DHE VEPRIMTARIA	BAZA	SHUMA
1	Paisjet për shitjen e akulloreve, pofkave, misrit, gështenjëve dhe të ngjajshme. Ngarkesa llogaritet në bazë mujore	m ²	5 €
2	Shfrytëzimi i sipërfaqeve para objekteve të biznesit për veprimtarin e cila është e lejuar të ushtrohet jashtë objektit dhe ekspozimin e mallrave të lejuara. Ngarkesa llogaritet në bazë mujore.	m ²	3 €
3	Objektet e përkohëshme lëvizëse dhe sezonale - konstrukcionet për lojra dhe të lunaparqeve. Ngarkesa llogaritet në bazë ditore.	m ²	0.30 €
4	Tavolinat lëvizëse për shitjen e lotarive, urimeve, panoramave dhe fotografive artistike, librave, lojrave të fatit dhe të ngjajshme . Ngarkesa llogaritet në bazë ditore.	m ²	1 €
5	Foltoret telefonike – Ngarkesa llogaritet në bazë vjetore	M ²	30 €
6	Panot dhe tabelat reklamuese - Ngarkesa llogaritet në bazë vjetore	M ²	50 €

Neni 15

Të hyrat nga shfrytëzimi i objekteve për manifestime, aktivitete kulturore dhe sportive

Këto të hyra i përcakton Drejtoria për Arsim, Rini, Sport dhe Kulturë , me rastin e dhënies në shfrytëzim të objekteve nga fushëveprimtaria e vet, si vijon :

Nr.	Emërtimi	Shuma
1	Shfrytëzimi i objekteve – sallave për manifestime dhe aktivitete kulturore	50 € / h
2	Shfrytëzimi i objekteve – sallave për aktivitete sportive	10 € / h
	Shfrytëzimi i sallave të bibliotekave në bazë të anëtarësisë vjetore : në qytet 2 € dhe në vendbanimet tjera 1 €.	

V. TË HYRAT NGA BASHKËPAGESAT

Neni 16

Bashkëpagesat për shëndetësi

Bashkëpagesat për shëndetësi i aplikojnë institucionet shëndetësore në Komunë sipas Udhëzimeve administrative të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë , përkitazi me bashkëpagesat nga shfrytëzuesit e shërbimeve shëndetësore.

Neni 17

Bashkëpagesat për arsim

Bashkëpagesat për arsimit i aplikojnë institucionet arsimore në Komunë sipas Udhëzimeve administrative të miratuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Neni 18

Ngarkesat për shfrytëzimin e burimeve natyrore

Ngarkesat për shfrytëzimin e burimeve natyrore do të aplikohen në bazë të dispozitave të miratuara nga Ministria për Energji dhe Miniera.

VI. TË HYRAT NGA GJOBAT KOMUNALE

Neni 19

Gjobat në trafik

Gjobat e shqiptuara për mosrespektimin e dispozitave në komunikacion në territorin e komunës do të inkasohen në Buxhetin e Komunës sipas procedurave të përcaktuara ligjore.

Neni 20

Gjobat për shkeljen e dispozitave të rregulloreve komunale

Kuvendi i Komunës me rastin e miratimit të rregulloreve të caktuara nga kompetenca e Komunës, do të parashef dispozita mbi shqiptimin e gjobave për shkeljen e dispozitave të rregulloreve komunale, të cilat do të inkasohen në Buxhetin e Komunës.

VII. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

Neni 21

Detyrat e organeve komunale

23.1 Organet komunale, sipas fushëveprimtarisë së vet, janë të obliguara që të zbatojnë dhe të inkasojnë të hyrat komunale nga subjektet – personat fizik dhe juridik sipas procedurave të përcaktuara me këtë Rregullore.

22.2 Obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa, që për dinamikën e realizimit të të hyrave buxhetore sipas kësaj Rregulloreje të informojë Kuvendin e Komunës për çdo tremujor.

22.3 Obligohen organet komunale, të cilat në implementimin e kësaj Rregulloreje, nxjerrin akte për caktimin e obligimeve të obliguesëve të pagesës së taksave, tarifave dhe gjobave, që me kopjen e këtyre akteve të njoftojnë Drejtorinë për Buxhet dhe Financa.

Neni 22 Detyrat e obliguesve

Obliguesit kanë për obligim të paguajnë shumat e caktuara të taksave, tarifave dhe gjobave, sipas mënyrës dhe afateve të përcaktuara me këtë Rregullore, përkatësisht në bazë të aktit të Organit përkatës së Komunës për përcaktimin e obligimit të pagesës.

VIII. PROCEDURA E ANKESAVE

Neni 23 Parashtrimi i ankesës

24.1 Obliguesi, i pakënaqur me llojin dhe lartësin e caktuar të taksës, tarifës ose të gjobës së shqiptuar sipas kësaj Rregulloreje, përkatësisht me aktin e Organit të Komunës me të cilin është përcaktue pagesa e obligimit, mund të parashtojë ankesë në pajtim me dispozitat e Ligjit për procedurën administrative.

24.2 Ankesa nuk e shtyen ekzekutimin e Vendimit.

IX. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Kjo rregullore do ta zëvendësojë Rregulloren për taksat, tarifat dhe gjobat komunale Nr. 01/283 datë 15/05/2009, me të gjitha ndryshimet dhe plotësimet e bëra në të.

Hyrja në fuqi Neni 24

Kjo Rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Shtërpcës.

KUVENDI I KOMUNËS SË SHTËRPCËS

Nr. 01/713 Më 01/06/2010
Shtërpcë

